

AKK - AZBPKNK - KACA

Nr. 01-458/09

Dt. 06.04.09

PRISHTINË - PRISHTINA

MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT

në mes

KOMISIONIT TË PAVARUR GJYQËSOR DHE PROKURORIAL

dhe

AGJENCISË KOSOVARE KUNDËR KORRUPSIONIT

për

Bashkëpunimin lidhur me verifikimin dhe përzgjedhjen e gjykatësve dhe prokurorëve në Kosovë

Përderisa Komisioni i Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial (më tutje KPGJP) dhe Agjencia Kosovare Kundër Korrupsionit (më tutje Agjencia) kanë për qëllim që kushtet e mëposhtme të rregullojnë përpjekjet e tyre të përbashkëta lidhur më projektin e verifikimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve të Kosovës.

A. Pjesëmarrësit:

KPGJP-ja dhe Agjencia janë pjesëmarrës në këtë marrëveshje për bashkëpunim në mes tyre dhe në këtë cilësi kanë nënshkruar këtë Memorandum të Mirëkuptimit (më tutje MiM).

B. Qëllimi dhe Fusha:

1. Themelimi i një Komisioni për të bërë shqyrtimin gjithëpërfshirës për të gjitha emërimet për pozitat e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Kosovë është rregulluar me Nenin 7 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/25 e cila fton për themelimin e një "Komisioni të Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial". Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) ka përgjegjësinë për të rekrutuar dhe përzgjedhur gjykatësit (dhe prokurorët në baza të përkohshme) sipas Rregullores nr. 2005/52. Në përputhje me këtë përkushtim ishte themeluar "Komisioni i Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial" brenda KGJK-së me qëllim që të bëjë shqyrtimin gjithëpërfshirës dhe përzgjedhjen e individëve, në nivel të Kosovës, të cilët do të emëroheshin për të shërbyer si gjykatës dhe prokuror deri në moshën e pensionimit, siç është përcaktuar me ligj në Kosovë. Ky proces rregullohet me dispozitat e Urdhëresës Administrative nr. 2008/2.
2. MiM përcakton përgjegjësitë e parapara për secilin pjesëmarrës lidhur me bashkëpunimin në mes tyre.

C. Përgjegjësitë e KPGJP-së:

1. Komisioni i Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial është themeluar sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/25 mbi Kornizën Rregullatore për Sistemin e Gjyqësisë në Kosovë brenda Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ku Sekretariati i tij është përgjegjës për zhvillimin e procesit të emërimit.
2. Qasje në të dhënat personale të kandidatëve mund të kenë vetëm anëtarët e KPGJP-së dhe stafi i Sekretariatit të KPGJP-së i autorizuar nga drejtori, me qëllim të arritjes së objektivave të KPGJP-së, siç është paraparë me Nenin 11, paragrafi 11.1 i Urdhëresës Administrative nr. 2008/2.
3. Siç është paraparë me Nenin 11, paragrafi 11.2 i Urdhëresës Administrative nr. 2008/2, KPGJP-ja dhe Sekretariati i KPGJP-së do të ndërmarrin masat e nevojshme për të garantuar nivelin e mbrojtjes së të dhënave personale që së paku është i barasvlershëm me atë që rezulton nga zbatimi i parimeve të Konventës së Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Individëve Lidhur me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale të datës 28 janar 1981 dhe ndryshimeve të saj të mëpastajme.

D. Përgjegjësitë e Agjencisë:

1. Me qëllim të kryerjes së detyrave të parapara me Ligjin Kundër Korrupsionit ishte themeluar një organ i njohur me emrin Agjencia Kosovare Kundër Korrupsionit si një prej masave brenda strategjisë për luftimin e korrupsionit. Siç është paraparë me Kreun 5 të Ligjit Kundër Korrupsionit, qëllimi kryesor i Agjencisë është mbikëqyrja e pasurisë së zyrtarëve të lartë dhe zhvillimi i hetimeve administrative të rasteve të pohuara të korrupsionit, siç është paraparë me Kreun 2, Neni 14 të këtij Ligji, me ç'rast nuk do të inicioheshin procedura penale.
2. Agjencia bashkëpunon me të gjitha autoritetet vendore dhe ndërkombëtare të ngarkuara për zbatimin e ligjit gjatë procedurave hetimore që kryhen nga këto autoritete, siç është paraparë me Kreun 2, Neni 23 të Ligjit Kundër Korrupsionit.
3. Agjencia do të ofroj informatat e kërkuara nga KPGJP-ja në pajtueshmëri me rregullat dhe procedurat e brendshme të Agjencisë. KPGJP-ja do të kërkojë informata nga të dhënat e Agjencisë të përshkruara në Kreun 6, Neni 46, paragrafi 46.2, pikat a), b) dhe e) të Ligjit Kundër Korrupsionit.

E. Ndryshimet dhe hyrja në fuqi:

1. Ky MiM mund të ndryshohet me pajtimin e Pjesëmarrësve.
2. Ky MiM hyn në fuqi me rastin e nënshkrimit nga ana e të dy pjesëmarrësve.

Për Komisionin e Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial:




.....
Peter Bach

Datë: 06 prill 2009

Drejtor i Sekretariatit të KPGJP-së

Prishtinë, Kosovë

Për Agjencinë Kosovare Kundër Korrupsionit:



.....
Hasan Preteni

Datë: 06 prill 2009

Drejtor i AKK-së

Prishtinë, Kosovë